



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 14, datë 06.02.2024

**PËR MIRATIMIN E SISTEMIMIT TË PËRKOHËSHËM TË FAMILJES SË Z.GJOKË
PJETËR MRRUKU NË BANESËN ME NR. PASURIE 4/82 + 1 - 22, LAGJJA NR.12,
DURRËS, NË PRONËSI TË BASHKISË DURRËS**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjin nr.22/2018, “Për strehimin social”, VKM-së nr.814, datë 3.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit” si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:



1. Miratimin e sistemimit të përkohëshëm të familjes së z. Gjokë Pjetër Mrruku në banesën me nr. pasurie 4/82+1-22, me sipërfaqe totale 93 m², Lagjja nr.12, Durrës, në pronësi të Bashkisë Durrës, miratuar nga Komisioni i Strehimit të Bashkisë Durrës.
2. Miratimin e masës së qirasë mujore me vlerë 100 lekë/m².
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe për vazhdimin e procedurave të mëtejshme, Drejtoria e Shërbimeve Publike në Bashkinë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 07.02.2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 97/14 prot.

Durrës, më 15.02.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.14 datë 06.02.2024 “Për miratimin e sistemimit të përkohshëm të familjes së Z.Gjokë Pjetër Mrruku në banesën me nr pasurie 4/82+1-22, Lagja Nr 12, Durrës, në pronësi të Bashkisë Durrës”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

